



## PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2013

I DETYRUAR

SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

VARIANTI **A**

**Lënda: Gjuhë shqipe dhe Letërsi**

**Profesionale, artistike, sportive, me kohë të shkurtuar**

*Udhëzime të përgjithshme:*

- Testi përbëhet nga dy pjesë.
  - Testi përmban një total prej 50 pikësh.
  - Testi ka 25 pyetje. 13 me zgjedhje dhe 12 me zhvillim.
  - Për pyetjet me zgjedhje, përgjigjja e saktë vlerësohet me 1 pikë.
  - Për pyetjet me zhvillim, përgjigjet konsiderohen orientuese dhe në skemë parashikohen variantet e mundësive të përgjigjeve të nxënësve.
  - Vlerësimi i pyetjes *ese* do të bëhet duke pasur parasysh rubrikat në tabelën e vendosur në fund të pyetjes dhe që është posaçërisht për vlerësuesit e testit.
- 

### **PJESA I**

*Shpirti i botës së gjallë*

Pyetja 1	C	1 pikë
Pyetja 2	C	1 pikë
Pyetja 3	D	1 pikë
Pyetja 4	A	1 pikë
Pyetja 5	D	1 pikë
Pyetja 6	C	1 pikë
Pyetja 7	A	1 pikë

---

**Pyetja 8**            **2 pikë**➤ **Karakteristikat gjuhësore:**

- Përdorimi i gjuhës së figurshme;
- Mbizotërimi i mbiemrave;
- Mbizotërimi i fjalive me detaje të hollësishme;
- Përdorimi i foljeve që tregojnë gjendje dhe emocione;
- Mbizotërimi i kohës së tashme dhe të pakryer
- Përdorimi i treguesve gjuhësorë hapësinorë (parafjalë, ndajfolje).

**2 pikë**            Nëse zbulon dy karakteristika gjuhësore, tipike për llojin e tij.

**OSE**

**1 pikë**            Nëse zbulon vetëm një karakteristike gjuhësore, tipike për llojin e tij.

**0 pikë**            Nëse përgjigjja e dhënë nuk i përmbahet pyetjes ose nuk ka përgjigje.

**Pyetja 9**            **2 pikë**

➤ **Objekti i përshkrimit:** kodra ose kodra si vendbanim i bletëve.

➤ **Ilustrimi:** *gjendet një kodër që ndahet në mes nga një përrua, është një kodër me labirinte.*

**1 pikë**            Nëse përcakton objektin e përshkrimit.

**DHE**

**1 pikë**            Nëse shkruan një shembull të përshkrimit objektiv që lidhet me kodrën.

**0 pikë**            Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 10**            **3 pikë**

➤ **Folja që shënon shqisën e të parit:** *fluturonin, pluhuri ngrihej, pluhurin që ishte ngritur aty më parë, kishte marrë ngjyrën e ndryshkut, punonin, sillnin.*

➤ **Folja që shënon shqisën e të dëgjuarit:** *dëgjohej zukatja, zhurmonte.*

➤ **Roli që luajnë në tekst:**

- nxit përfytyrimin dhe emocionin,
- krijon një lloj perceptimi tingullor,
- e bën imazhin më të gjallë, më lëvizës, më të prekshëm; të duket sikur e shikon dhe sikur dëgjon.

**1 pikë**            Nëse identifikon foljen që shënon shqisën e të parit.

**1 pikë**            Nëse identifikon foljen që shënon shqisën e të dëgjuarit.

**1 pikë**            Nëse tregon rolin që ato luajnë në tekst.

**0 pikë**            Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 11**      **2 pikë****➤ Funkzioni:**

- Koha e tashme tregon përjetimin aktual të autores. Është pikërisht kjo kohë që e shtyn të bëjë një “udhëtim” imagjinar në të shkuarën, e cila gjuhësisht jepet me kohën e pakryer.
- Koha e pakryer e kthen autoren në të kaluarën, i zgjon kujtimet dhe përjetimet e dikurshme.

**1 pikë**      Nëse shpjegon funksionin e kohës së tashme.

**DHE**

**1 pikë**      Nëse shpjegon funksionin e kohës së pakryer.

**0 pikë**      Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 12 (a)**      **2 pikë****➤ Arsyet:**

- dëshira për vetmi, qetësi;
- dëshira për t’u *arratisur* nga një realitet që e lodh dhe që ajo e përjeton si të egër;
- dëshira për pak paqe, të cilën e gjen vetëm në natyrë;
- dashuria për natyrën;
- ndjesia e sigurisë që i fal natyra.

**2 pikë**      Nëse identifikon dy nga arsyet që e shtynjë autoren të largohet nga realiteti.

**OSE**

**1 pikë**      Nëse identifikon vetëm një arsye që e shtyn autoren të largohet nga realiteti.

**0 pikë**      Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 12 (b)**      **1 pikë****➤ Mesazhi:**

- Qetësia shpirtërore fitohet pranë natyrës;

**OSE**

- Natyra dhe bota e gjallë kanë shpirtin e tyre, që sjell harmoni dhe prehje edhe për njeriun.

**OSE**

- Njeriu i lodhur gjen qetësi dhe prehje në natyrë.

**1 pikë**      Nëse shkruan mesazhin që përcjell teksti

**0 pikë**      Nëse përgjigjet gabim, mungon njëra nga ndryshimet e duhura ose nuk përgjigjet fare.

*Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, shkruan një mesazh që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.*

**Pyetja 12 (c) 2 pikë****➤ Kontrasti:**

- Egërsia e botës njerëzore- qetësia dhe paqja e natyrës.

**OSE**

- Ëndrra - realiteti

**➤ Shpjegimi**

- Kontrasti thekson idenë se bota njerëzore ka fituar egërsi, ndërkohë që natyra mbetet një vend i qetë dhe i paqtë.

**OSE**

- Thekson pamundësinë për t'u *arratisur* nga një realitet *i egër*, ku nuk ndihesh rehat e nuk gjen qetësi. Dhe kjo *arratisje* është e mundur vetëm përmes ëndërrimit.

**1 pikë** Nëse identifikon kontrastin.

**DHE**

**1 pikë** Nëse shpjegon kontrastin.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim, mungon njëra nga ndryshimet e duhura ose nuk përgjigjet fare.

*Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.*

**PJESA II****De Rada*****Këngët e Milosaos***

<b>Pyetja 13</b>	<b>D</b>	<b>1 pikë</b>
<b>Pyetja 14</b>	<b>B</b>	<b>1 pikë</b>
<b>Pyetja 15</b>	<b>A</b>	<b>1 pikë</b>
<b>Pyetja 16</b>	<b>A</b>	<b>1 pikë</b>
<b>Pyetja 17</b>	<b>D</b>	<b>1 pikë</b>
<b>Pyetja 18</b>	<b>D</b>	<b>1 pikë</b>

**Pyetja 19**      **3 pikë**➤ **Atmosfera:***Përgjigjja e plotë*

- Jemi në fund vjeshte, prag dimri. Natyra është e zymtë, e ashpër. E gjitha kjo theksohet me erën që fryn nga malet dhe që rrëzon gjethet e pemëve, duke shkretuar gjithçka.

*Përgjigjja e pjeshme*

E konstaton atmosferën:

- e zymtë;
- e ashpër;
- e ftohtë;
- e trishtë;
- e shkretë.

➤ **Funksioni artistik:**

- Paralajmëron vdekjen e heroit;
- Luan rolin e një paralelizmi figurativ: mbyllja e ciklit të natyrës shkon paralelisht me mbylljen e ciklit të jetës së heroit.
- Një tipar romantik, pjesëmarrja e natyrës.

**2 pikë**      Nëse përshkruan në mënyrë të plotë atmosferën që mbizotëron në këtë këngë.

**OSE**

**1 pikë**      Nëse përshkruan në mënyrë të pjeshme atmosferën që mbizotëron në këtë këngë.

**DHE**

**1 pikë**      Nëse tregon funksionin artistik të këtij përdorimi.

**0 pikë**      Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 20**      **2 pikë**➤ **Gjymtyra që mungon: folja**➤ Gjaku im *rrodhi* (*u derdh*) te lumi i Vodhit

**1 pikë**      Nëse gjen se gjymtyra që mungon është folja.

**DHE**

**1 pikë**      Nëse e rishkruan vargun duke shtuar një folje që lidhet me kontekstin e dhënë.

**0 pikë**      Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 21 (a) 3 pikë****➤ Çfarë kërkon Milosao?**

- Kërkesa e fundit e Milosaos para se të vdesë është që të shohë Shkodrën dhe motrën.

**➤ Pse:**

- Shkodra nënkupton lidhjen me vendlindjen, motra është i vetmi person i familjes që i ka mbetur.

**OSE**

- Janë dy gjërat e shtrenjta që i kanë mbetur: vendlindja dhe familja, dhe ai do të ndahet përfundimisht me to.

**➤ Ndjenjat që e përshkojnë heroin:**

- Trishtimi, dhimbja e ndarjes nga jeta, nostalgjia për gjërat që lë pas.

**1 pikë** Nëse tregon se çfarë kërkon të shohë në fund Milosao.

**DHE**

**1 pikë** Nëse shpjegon arsyen.

**DHE**

**1 pikë** Nëse tregon se ç'ndjenjë e përshkon heroin.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 21 (b) 1 pikë****➤ Tipari romantik:**

- Theksimi i ndjenjave që e përshkojnë heroin, si: *trishtimi, vetmia, nostalgjia, malli*.

**1 pikë** Nëse zbulon një tipar të Milosaos, që e bën hero romantik.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 22 3 pikë****➤ Koha e foljeve: e tashme (mblidhen) dhe e kryera e thjeshtë (lashë).****➤ Shpjegimi:**

- E kryera e thjeshtë thekson largimin e tij përfundimtar nga kjo jetë, por jeta do të vazhdojë edhe më pas (e tashmja shpreh një veprim në vazhdimësi).

**OSE**

- Milosao po vdes, por jeta vazhdon, të tjerë do ta vazhdojnë atë.

**OSE**

- Edhe pas vdekjes së Milosaos, jeta do të vazhdojë.

**2 pikë** Nëse gjen dy kohët e foljeve.

**DHE**

**1 pikë** Nëse shpjegon funksionin e tyre.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 23**                      **2 pikë**➤ **Mënyra e ndërtimi:**

- Fjala **ëndërrëz** është formuar me prapashtesë (mënyra e ndërtimit: me prapashtesim).

**OSE**

- ëndërr + ëz

➤ **Përfytyrimi:**

- Prapashtesa zvogëluese sjell përfytyrimin e diçkaje të vogël, që në kontekstin e këngës, ka domethënie e jetës së shkurtër që po ikën, po mbaron.

**OSE**

- Jeta e njeriut është e kufizuar, e shkurtër dhe kjo fjalë thekson pikërisht sa shpejt ikën ajo. Ashtu si mbaron ëndrra, sa hap e mbyll sytë, ashtu i duket edhe Milosaos jeta, kur ndodhet në fund të saj.

**1 pikë**                      Nëse gjen mënyrën e fjalëformimit.

**DHE**

**1 pikë**                      Nëse shpjegon përfytyrimin që nxit kjo fjalë.

**0 pikë**                      Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 24**                      **1 pikë**➤ **Imazhi i malit dhe i lisit:**

Mali dhe lisi nënkuptojnë:

- forcën,
- qëndresë,
- rreptësinë,
- ashpërsinë,
- trashëgiminë.

**1 pikë**                      Nëse tregon se ç'përfaqëson imazhi i malit dhe i lisit.

**0 pikë**                      Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 25**                      **8 pikë**

Për esenë do të ndiqen kriteret e mëposhtme:

**KRITERI I: SHTJELLIMI I IDESË**    **2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- shkruan një ese, ku argumenton se përshtypjet e para mund të jenë ose jo të ndryshueshme;
- mban qartë një pozicion të dukshëm në zgjedhjen e bërë;
- përdor shembuj dhe arsye specifike për të mbështetur përgjigjen e dhënë, duke iu referuar përvojës personale ose edhe përvojave të të tjerëve;
- ka qartësi mendimi.

**KRITERI II: ORGANIZIMI DHE STRUKTURA E ESESË**                      **2 pikë****1 pikë**                      **Struktura e esesë**

- respekton elementet e strukturës së esesë:
  - hyrjen,
  - zhvillimin,
  - përfundimin.

Nxënësi merr **1 pikë** nëse përgjigjen e dhënë e strukturon sipas skemës së mësipërme.

**1 pikë**                      **Organizimi i esesë**

- organizim logjik, ku shfrytëzohen teknika të tilla, si: koherenca dhe unifikimi i paragrafëve (lidhja logjike mes paragrafëve, kalimi në mënyrë të natyrshme nga njëri paragraf te tjetri).

**KRITERI III: STILI DHE ORIGJINALITETI**    **2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- përmes gjuhës që përdor, krijon një përshtypje të përgjithshme për atë që do të shprehë;
- shprehet me një gjuhë eseistike;
- ka fjalor të pasur;
- stil origjinal.

**KRITERI IV: SAKTËSIA GJUHËSORE**    **2 pikë****(1 pikë sintaksa dhe 1 pikë drejtshkrimi)**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- strukturon qartë përgjigjen nga pikëpamja gramatikore;
- ndërton fjali që janë të sakta dhe të qarta;
- përdor fjali që variojnë në modele, gjatësi dhe ritëm;
- ka saktësi drejtshkrimore.